



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202100588/14

Tiranë ___/___/2022

Lënda: *Rekomandim për koordinimin e veprimeve ndërmjet institucioneve të përfshira në procedurën e njohjes së vendimit të huaj për të garantuar të drejtat e shtetasve shqiptarë që do të transferohen në vendin tonë për të vuajtur pjesën e mbetur të dënimit të dhënë nga një gjykatë huaj.*

MINISTRISË SË DREJTËSISË

Tiranë

PROKURORISË SË PËRGJITHSHME

Tiranë

KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Tiranë

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë i dënuari A. Ll., i cili ankohet ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, që e ka dënuar në mungesë me burgim të përhjetshëm në përfundim të procesit gjyqësor për njohjen e një vendimi të Gjykatës së Mbretërisë në Winchester që e kishte dënuar atë me 32 vite burgim për veprën penale të "Vrasjes me paramendim"¹. Ankuesi shprehet se është njohur me vendimin e gjykatës shqiptare kur i është komunikuar transferimi

¹ Sa më sipër është pretendimi i ankuesit.

për në Shqipëri, ndërsa ndodhej në burg në Angli, dhe pas transferimit në vendin tonë nuk ka mundur të kundërshtojë vendimin për mungesë të njohurive ligjore dhe të pamundësive financiare për të paguar një avokat.

Për verifikimin e kësaj ankese jemi interesuar fillimisht në IEVP Peqin², në Gjykatën e Shkallës së Parë Mat³ dhe në Prokurorinë pranë kësaj gjykate⁴, ku kemi kërkuar të na vihet në dispozicion dokumentacioni që ka të bëjë me procesin gjyqësor dhe procedurën e transferimit.

Më konkretisht kemi kërkuar të informohemi nëse është njoftuar shtetasi A. Ll. lidhur me nisjen e procesit gjyqësor me objekt njohjen e vendimit të huaj, a i është kërkuar të shprehet nëse kërkon të përfaqësohet nga avokat i përzgjedhur prej tij apo me avokat kryesisht, nëse ky shtetas është njohur me vendimin gjyqësor të shkallës së parë në mënyrë që ta apelonte atë, a është apeluar prej të dënuarit vendimi i gjykatës së shkallës së parë, kush e ka përfaqësuar në gjykatën e apelit dhe nëse shënohet në dispozitivin e vendimit të gjykatës e drejta e ankimit.

Referuar dokumentacionit që na është vënë në dispozicion rezulton se shtetasi A. Ll., me vendimin penal të huaj të datës 20.02.2013, është dënuar nga Gjykata e Mbretërisë në Winchester me burgim të përjetshëm, me të drejtën për të kërkuar lirim me kusht pasi të ketë kryer 32 vite burgim, për veprën penale të *“Vrasjes dhe pengim të udhës së drejtësisë publike”*. Ky shtetas ka bërë kërkesë në datën 06.03.2013, drejtuar autoriteteve britanike, që të transferohet në Shqipëri për të vuajtur dënimin me burgim. Në datën 02.04.2013, autoriteti përkatës në Mbretërinë e Bashkuar, ia ka përcjellë këtë kërkesë Ministrisë së Drejtësisë së Shqipërisë bashkë me disa kërkesa për informacion që lidhen me procedurën e transferimit. Me shkresën Nr.1403 Prot./D.S, datë 10.04.2015, Ministria e Drejtësisë i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme me kërkesë për vijimin e procedurës për njohjen e vendimit të huaj në ngarkim të shtetasit A. Ll., me qëllim transferimin e tij. Në vijim, Prokuroria e Përgjithshme ia ka përcjellë këtë kërkesë Prokurorisë

² Shkresa me Nr.K2/A13-2 Prot., datë 16.04.2021.

³ Shkresat me Nr.K2/A13-4 Prot., datë 27.04.2021 dhe Nr.A13-6 Prot., datë 17.06.2021.

⁴ Shkresa me Nr.K2/A13-8 Prot., datë 31.08.2021.

pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat me shkresën Nr. 1359/3, datë 04.05.2014. Çështja është paraqitur në gjykatë për shqyrtim, dhe me Vendimin Nr.2, datë 13.01.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat është pranuar kërkesa e prokurorisë për njohjen e vendimit të huaj, të Gjykatës së Mbretërisë në Winchester, për shtetasin A. Ll., duke e dënuar atë me burgim të përjetshëm. Ky shtetas gjatë procesit gjyqësor është përfaqësuar në mungesë nga Av. S. H., e caktuar kryesisht. Ish kancelarja e gjykatës ka dërguar vendimin e sipërpërmendur për ekzekutim pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat, por nuk i është dhënë formë e prerë. Ndërkohë, në datën **05.05.2016**, Grupi i Forcës Operacionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve ka marrë në dorëzim këtë shtetas në mjediset e Komisarariatit të Policisë Rinas dhe e ka dërguar në IEVP “Jordan Misja”, Tiranë. Me shkresën nr.555 prot., datë **11.05.2016** të drejtuesit të Prokurorisë Mat, Z. A. M., i është kërkuar gjykatës t’i japë formë të prerë vendimit nëse nuk është ankimuar. Nga ana e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat është urdhëruar verifikimi i regjistrave të ankimit dhe ka rezultuar se për Vendimin nr.2, datë 13.01.2016 nuk ka patur ankim nga palët (Prokuroria dhe mbrojtësi kryesisht i të dënuarit A. Ll.). Në këto rrethana nga ana e tij është urdhëruar t’i jepet vendimit gjyqësor forma e prerë në datën 11.05.2016. Gjithashtu i dënuari A. Ll. nuk ka paraqitur kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit. Transferimi është kryer bazuar në Konventën e Këshillit të Europës “*Për transferimin e personave të dënuar*”, nënshkruar në Strasburg më 21.03.1983, ratifikuar me Ligjin Nr.8499, datë 10.06.1999, në Ligjin Nr.10193, datë 03.12.2009 “*Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale*” dhe në Ligjin Nr.98/2013 “*Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Madhe e Irlandës së Veriut për transferimin e personave të dënuar*”.

Meqënëse dokumentacioni që na u vu në dispozicion nuk u jepte përgjigje disa prej pyetjeve tona të lartpërmendura, për sa i përket garancive të të dënuarit në procesin e njohjes së vendimit të huaj nga gjykata shqiptare, iu drejtuam me të njëjtat pyetje Ministrisë së Drejtësisë⁵. Ne fokus të interesimit tonë ishte jo vetëm verifikimi i ankesës së shtetasit A. Ll., por edhe qartësimi i procedurës që do të ndiqet në vijim

⁵ Shkresa K2/A13-9 Prot., datë 31.08.2021.

lidhur me të dënuarit shqiptarë që do të transferohen për të vuajtur në vendin tonë dënimin me burgim.

Në përgjigjen që kemi marrë nga Ministria e Drejtësisë me shkresën Nr.3304/3 Prot./D.S, datë 15.12.2021, në mënyrë të përmbledhur, jepet shpjegimi si më poshtë:

“Në lidhje me faktin nëse është njohur shtetasi A. Ll. lidhur me nisjen e procesit gjyqësor me objekt njohjen e vendimit të huaj, njoftimin e kryen autoriteti kompetent i shtetit dënues pas paraqitjes së kërkesës së subjektit, në bazë të legjislacionit të tij procedural.

Në lidhje me të drejtën e përfaqësimit në çështjen gjyqësore që nuk shqyrtohet në themel, por vetëm në procedurë, mbi njohjen dhe ekzekutimin e vendimit penal të huaj të dhënë ndaj kërkuarit, në kushtet kur kërkuari ndodhet në sistemin penitenciar të shtetit dënues, bëjmë më dije se, është autoriteti i shtetit dënues kompetent për realizimin e njoftimit gjatë gjithë procesit, pasi subjekti të ketë paraqitur kërkesën për ushtrimin e kësaj të drejte. Vetë i dënuari që do të transferohet duhet të paraqesë tek autoriteti dënues kërkesë për të caktuar një mbrojtës ligjor dhe kjo kërkesë i përcillet autoritetit ekzekutues.

Në lidhje me faktin nëse është njoftuar shtetasi A. Ll. lidhur me nisjen e procesit gjyqësor me objekt njohjen e vendimit të huaj, ky njoftim kryhet nga autoriteti kompetent i shtetit dënues pas paraqitjes së kërkesës së subjektit, në bazë të legjislacionit të tij procedural.

Në lidhje me procedurën e njohjes me vendimin e konvertuar të gjykatës, shtetasin që mbahet i burgosur jashtë vendit, në mënyrë që ai të ushtrojë efektivisht të drejtën e ankimit, është autoriteti i shtetit dënues që njofton për çdo fazë të shqyrtimit gjyqësor ku i dënuari është palë”.

Sikurse referohet në përgjigjen e Ministrisë së Drejtësisë dhe në kërkesën e prokurorisë për njohje vendimi të huaj drejtuar gjykatës, procedura e transferimit të shtetasit A. Ll. është kryer bazuar në “Marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Madhe e Irlandës së Veriut për Transferimin e Personave të dënuar”, Ligjin Nr.7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale

i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në Ligjin Nr.10193, datë 03.12.2009 “*Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështje penale*”.

Për shkak të problematikës së hasur nga autoritetet shqiptare gjyqësore gjatë zbatimit për arsye të ndryshimeve të sistemeve ligjore, të cilat sillnin si pasojë rëndimin e pozitës juridike të të dënuarit në disa raste, me Ligjin Nr.125/2021, vendi ynë ka rishikuar “*Marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Madhe e Irlandës së Veriut për Transferimin e Personave të dënuar*”⁶.

Një akt tjetër rregullator i procesit të njohjes së vendimit të huaj penal është edhe Ligji Nr.8499, datë 10.06.1999 “*Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës* “*Për transferimin e personave të dënuar*”.

Nga legjislacioni i lartpërmendur, specifikisht në Ligjin Nr.10193, datë 03.12.2009 “*Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështje penale*” parashikohen rregulla të hollësishme për procedurën e njohjes së vendimeve penale të huaja nga gjykatat tona.

Më konkretisht, në Kreun IV, Seksioni I (Ekzekutimi i vendimeve penale të huaja), në nenin 56 (*E drejta e mbrojtjes me avokat*) parashikohet se:

“Gjatë gjykimit, personit ndaj të cilit kërkohet njohja dhe ekzekutimi penal i huaj, ka të drejtën e mbrojtjes të zgjedhur ose të caktuar, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Penale”.

Ndërsa, në nenin 57 (Mënyra e procedimit nga gjykata) parashikohet:

“1. Brenda dhjetë ditëve nga depozitimi i kërkesës së prokurorit, gjyqtari i çështjes cakton datën e seancës gjyqësore dhe urdhëron njoftimin e palëve.”

⁶ Njohja e vendimit të huaj për shtetasin A. Ll. është një nga rastet kur pozita juridike e të dënuarit është rënduar nga gjykata shqiptare.

2. Seanca zhvillohet me pjesëmarrjen e detyrueshme të prokurorit dhe të mbrojtësit.

3. Në marrjen e vendimit për kërkesën, gjykata merr parasysh faktet e konstatuara në vendimin e huaj.

4. Në caktimin e dënimit, gjykata respekton kushtet e nenit 516 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe mbështetet në legjislacionin penal shqiptar, duke arsyetuar edhe rrethanat e vlerësuara.

5. Për depozitimin e vendimit në sekretari dhe njoftimin e tij zbatohen rregullat e Kodit të Procedurës Penale.

6. Vendimi mund të ankimohet në një gjykatë të një niveli më të lartë nga prokurori, i dënuari ose mbrojtësi i tij brenda 10 ditëve nga shpallja ose njoftimi i tij".

Në vijim, në nenin 58 (Përcjellja e vendimit) përcaktohet si vijon:

"1. Prokurori i Përgjithshëm i përcjell Ministrisë së Drejtësisë, brenda 15 ditëve nga marrja formë të prerë, kopjen e vendimit gjyqësor për njohjen e vendimit penal të huaj.

2. Ministria e Drejtësisë, brenda 10 ditëve nga marrja e vendimit të njohjes nga Prokurori i Përgjithshëm, njofton shtetin dënues".

Në analizën e rastit objekt i hetimit tonë administrativ, me shumë interes është edhe qëndrimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me Vendimin Nr.5, datë 10.10.2002⁷. Kolegjet kanë unifikuar praktikën gjatë shqyrimin të një çështje që ka të bëjë me pretendimet e një shtetasi shqiptar lidhur me njohjen e vendimit të huaj penal, për efekt të transferimit në vendin tonë për të vuajtur dënimin, shtetas i cili nuk është përfaqësuar gjatë procesit gjyqësor as nga një avokat i caktuar prej tij dhe as nga një mbrojtës i caktuar kryesisht nga gjykata.

Për sa i përket të drejtës së të dënuarit për mbrojtës ligjor, në këtë Vendim thuhet:

⁷ Për më tepër, shih: https://www.pp.gov.al/rc/doc/vendime_unifikuese_penale_1999_2015_neë_1081.pdf

“...Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë të mendimit që si prokurorit, ashtu edhe mbrojtësit të të dënuarit, për të cilin bëhet konvertimi i dënimit të huaj, nuk mund t’u mohohet e drejta e ankimit kundër vendimit të gjykatës për këtë çështje, megjithëse ky lloj gjykimi nuk është gjykim themeli, por një gjykim i posaçëm (sui generis).

Vendimi i konvertimit të dënimit të huaj në përshtatje me legjislacionin shqiptar, që jepet nga gjykata shqiptare, **pavarësisht nga natyra e tij, është në fund të fundit një vendim gjyqësor dhe, sipas nenit 43 të Kushtetutës, “Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe”.**

Gjykimi i konvertimit, nga natyra e tij dhe rrethanat objektive në të cilat zhvillohet, nuk mund të ketë praninë e të dënuarit që u ka kërkuar autoriteteve të huaja kompetente të transferohet në Shqipëri. I dënuari që është duke vuajtur dënimin me burgim në një shtet të huaj objektivisht nuk mund të paraqitet në gjykatën shqiptare, por ai ka të drejtë dhe ka mundësi që, në momentin kur u drejtohet autoriteteve të huaja për të nisur procedurën e transferimit, të autorizojë një mbrojtës të tij që ta përfaqësojë në gjykatën shqiptare. Në qoftë se në fillim të gjyqësorit të konvertimit, gjykata shqiptare konstaton se mbrojtësi i caktuar nga i dënuari nuk është paraqitur pa shkaqe të arsyeshme, ose ai nuk ka autorizuar ndonjë mbrojtës, atëherë gjykata është e detyruar t’i caktojë një të tillë kryesisht. Vendimi i konvertimit mund të ankimohet nga palët ne Apel. Vetëm pasi vendimi i konvertimit merr formë të prerë prokurori ka të drejtë të kryejë veprimet e ekzekutimit, nëpërmjet dërgimit të akteve Ministrisë së Drejtësisë për të vazhduar kryerjen e veprimeve administrative me autoritetet e huaja nëpërmjet të cilave do të realizohet transferimi i të dënuarit.

... Duke qenë se prokurori është i ngarkuar ligjërisht me ekzekutimin e vendimit, është detyrë e tij që të sigurohet nëse vendimi ka marrë formë të prerë, pastaj të vejë në lëvizje Ministrinë e Drejtësisë për transferimin e të burgosurit.

... Prokurori është i detyruar ligjërisht të garantojë paraprakisht që, kur i dënuari të ketë realizuar të drejtën e transferimit nga vendi i huaj në Shqipëri për të vazhduar të vuajë dënimin e dhënë nga gjykata e huaj dhe të konvertuar sipas legjislacionit shqiptar, të jenë kryer të gjitha veprimet procedurale dhe

administrative midis autoriteteve shqiptare dhe atyre të huaja në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi, si dhe të jenë respektuar rigorozisht të drejtat e të dënuarit të transferuar, dhe, për rrjedhojë, këtij të fundit në kohën e kthimit në Shqipëri t'i jenë mbyllur ligjërish të gjitha rrugët e zakonshme të ankimit".

Pra, sikurse evidentohet nga legjislacioni që rregullon këtë fushë dhe vendimi unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vetëm pasi vendimi i konvertimit të dënimit të huaj të marrë formë të prerë, ai mund të ekzekutohet. Gjithashtu, institucionet e përfshira në procedurën e njohjes së vendimit penal të huaj duhet të kenë rol aktiv për të siguruar mbrojtjen ligjore të të dënuarit që do të transferohet, me avokat të zgjedhur prej tij ose me avokat të caktuar kryesisht, dhe për të siguruar se ky i dënuar është njohur me vendimin e marrë ndaj tij, në kuadër të respektimit në mënyrë thelbësore të të drejtave të tij.

Nga hetimi administrativ i ankesës së paraqitur nga i dënuari A. Ll. dhe dokumentacioni i administruar konstatojmë se procesi i transferimit të tij në Shqipëri është kryer në kohë, përpara se vendimit të konvertimit t'i jepej forma e prerë nga ish kancelarja e Gjykatës së Shkallës së Parë Mat. Pra, pavarësisht se në procedurën e parashikuar në Ligjin Nr.10193, datë 03.12.2009, Prokurori i Përgjithshëm i përcjell Ministrisë së Drejtësisë kopjen e vendimit gjyqësor për njohjen e vendimit penal të huaj brenda 15 ditëve nga marrja formë të prerë, në fakt shtetasi A. Ll. është marrë në dorëzim nga grupi i Forcës Operacionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve në mjediset e Komisarariatit të Policisë Rinas, 6 ditë përpara se t'i jepej forma e prerë.

Seanca e parë gjyqësore për njohjen e vendimit penal të huaj për shtetasin A. Ll. është zhvilluar në datën 14.09.2015 dhe gjyqtari i çështjes ka vendosur që ai të përfaqësohet nga avokati i caktuar kryesisht. Gjithashtu, nga dokumentacioni që na është vënë në dispozicion nuk rezulton që autoritetet e vendit tonë të kenë vënë në dijeni për këtë fakt autoritetet britanike, në mënyrë që këto të fundit të njoftonin të dënuarin se kishte nisur procesi gjyqësor lidhur me kërkesën e tij për transferim. Megjithëse për këtë lloj gjykimi të veçantë, nuk parashikohen norma të posaçme

për të drejtat e të dënuarit gjatë procesit gjyqësor, duke iu referuar edhe vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të lartpërmendur, pavarësisht natyrës së tij, kemi të bëjmë me një vendim gjyqësor dhe, sipas nenit 43 të Kushtetutës, “*Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe*”. E drejta për t’u ankuar, veçanërisht kur personi është në pamundësi objektive për të marrë pjesë në seancat gjyqësore dhe për të qenë në territorin e vendit tonë, lidhet në mënyrë të pashmangshme me të drejtën për t’u përfaqësuar me një mbrojtës ligjor dhe të drejtën për t’u njohur me vendimet që merren ndaj tij. Për këtë arsye, çmojmë të evidentojmë se të njëjtat garanci që i njihen të pandehurit në procesin penal, duhet të zbatohen edhe për të dënuarin. Në këtë kuadër, vlerësojmë të sjellim në vëmendje Vendimin unifikues nr.1, datë 10.03.2014 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë⁸, që kanë arritur në disa përfundime lidhur me përfaqësimin në procesin penal, si më poshtë vijon:

- E drejta për ankim, në vështrim të përcaktimit ligjor të bërë nga ligjvënësi në nenin 50, pika 1 dhe 410 të Kodit të Procedurës Penale, është një e drejtë e cila i rezervohet personalisht të pandehurit.
- I pandehuri lejohet që personalisht të delegojë të drejtën për të bërë ankim tek mbrojtësi. Akti i delegimit mund të jetë në të njëjtin akt me të cilin bëhet zgjedhja e mbrojtësit, ose në një akt të veçantë.
- I pandehuri lejohet gjithashtu të delegojë të drejtën për të bërë ankim tek mbrojtësi, duke ushtruar këtë vullnet nëpërmjet delegimit tek një i afërm. I afërmi nuk zgjedh mbrojtës dhe as nuk delegon të drejtën për ankim në mënyrë autonome. Ankimi i mbrojtësit të zgjedhur nga të afërmit lejohet vetëm nëse provohet se (i) zgjedhja e mbrojtësit, dhe (ii) delegimi i mbrojtësit për të ushtruar ankim, është rezultat i vullnetit të plotë eksplicit të titullarit të kësaj të drejte, që është i pandehuri.
- Në rastin e të gjykuarit në mungesë, si mbrojtësi i caktuar nga gjykata, ashtu edhe ai i zgjedhur nga të afërmit e të pandehurit (i cili siç u tha më

⁸Për më tepër, shih:

http://webcache.googleusercontent.com/search?q=cache:LnsbqmcH0b4J:www.gjykataelarte.gov.al/web/1_kb_unifikues_ervis_nurkaj_1221.doc+&cd=1&hl=en&ct=clnk&gl=al

lart, konsiderohet të ketë të njëjtat tagra me atë të caktuar nga gjykata) nuk janë mbrojtës të zgjedhur personalisht nga i pandehuri. Rrjedhimisht, titullari i së drejtës nuk ka deleguar të drejtën e tij për të bërë ankim.

- Mbrojtësi i caktuar nga gjykata, apo i zgjedhuri nga një i afërm i të pandehurit, i cili është gjykuar në mungesë, sipas përcaktimit të bërë nga ligjvënësi në pikën 3 të nenit 38 të Kodit të Procedurës Penale, nuk legjitimohet të bëjë ankim kundër vendimit të dënimit të dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë.
- Në çdo rast, i dënuari në mungesë ka të drejtë të kërkojë rivendosjen në afat për të ushtruar ankim në apel ose rekurs në Gjykatën e Lartë, përveç rasteve kur ka prova të mjaftueshme se:
 - (i) Kishte dijeni për gjykimin e zhvilluar kundër tij;
 - (ii) Në mënyrë direkte ose të tërthortë, ka autorizuar familjarët për t'u ankimuar në apel ose
 - (iii) Ka hequr dorë në mënyrë eksplicite nga e drejta e tij për të qenë i pranishëm në gjykimin kundër tij, duke u fshehur nga drejtësia.

Nga hetimi administrativ i rastit, rezulton se avokati i caktuar kryesisht për të dënuarin A. Ll., nuk ka bërë ankim ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Mat. Ndërkohë, Ministria Drejtësisë i ka përcjellë Ministrisë së Drejtësisë të Mbretërisë së Bashkuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Mat, për njohjen e vendimit të huaj, në gjuhën angleze, por pa sqaruar nëse vendimi ishte i formës së prerë. Ministria e Drejtësisë në përgjigjen që na ka kthyer shprehet se është autoriteti i shtetit dënues kompetent për realizimin e njoftimit gjatë gjithë procesit, pasi subjekti të ketë paraqitur kërkesën për transferim. Çmojmë se në kushtet kur procesi gjyqësor i njohjes së vendimit penal të huaj zhvillohet në vendin pritës, së pari është përgjegjësi e autoriteteve të vendit tonë të kryejnë veprimet procedurale për të siguruar të drejtën e të dënuarit për t'u përfaqësuar dhe për t'u njohur me vendimin që merret ndaj tij. Për më tepër, që nga data e paraqitjes së kërkesës për transferim e deri në datën kur nis procesi gjyqësor i njohjes së vendimit të huaj kalon një kohë relativisht e gjatë, e nevojshme për shkëmbimin e dokumentacionit

ndërmjet institucioneve. Në rastin konkret kanë kaluar rreth 2 vite e 6 muaj. Pavarësisht se nuk parashikohet në marrëveshjet për transferimin e personave të dënuar, që të ketë letërkëmbim ndërmjet shteteve palë për sa i përket shprehjes së vullnetit të të dënuarit për t'u përfaqësuar në gjykatë dhe njohjes me vendimin e gjykatës, nuk ka pengesë që institucionet tona t'i përcjellin dokumentacion për këto të drejta shtetit transferues për t'ia vënë në dispozicion të dënuarit dhe të marrin konfirmim që ai është vënë në dijeni dhe është shprehur.

Nga ana tjetër, në dispozitivin e Vendimit Nr.2, datë 13.01.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë Mat për njohjen e vendimit penal të huaj për shtetasin A. Ll., nuk është shënuar e drejta e ankimit dhe afati për të ushtruar këtë të drejtë. Një shqetësim i tillë është bërë edhe më parë objekt i rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit. Referuar nenit 383⁹ “*Elementët e vendimit*” të Kodit të Procedurës Penale, nuk përcaktohet se vendimi duhet të përmbajë edhe të drejtën e ankimit, përfshirë gjykatën ku mund të paraqitet ankimi, afatin dhe mënyrën e përlllogaritjes së tij për paraqitjen e ankimit. Duke patur në konsideratë faktin që jo të gjithë shtetasit e njohin në hollësi e detaje legjislacionin dhe gjendja jo e mirë ekonomike për shumë prej tyre u pamundëson këshillimin ligjor nga profesionistë të fushës, veçanërisht kur kemi të bëjmë me të burgosur, vlerësojmë se në praktikën e vendimeve penale, në pjesën e dispozitivit të shënohet afati i ankimit, gjykata ku mund të paraqitet ankimi dhe përlllogaritja e afatit. Kjo do të garantonte efektivisht një proces të rregullt ligjor, dhe konkretisht ushtrimin e së drejtës së ankimit nga palët në proces për të kundërshtuar një vendim gjyqësor në një gjykatë më të lartë. Mirëkuptojmë ngarkesën dhe vështirësitë aktuale në sistemin gjyqësor për shkak të zbatimit të reformës në drejtësi në përgjithësi dhe mungesave në kapacitete për

⁹ Neni 383 “Elementët e vendimit” i KPrP, parashikon:

“1. Vendimi përmban:

a) gjykatën që e ka dhënë;

b) gjeneralitetet e të pandehurit ose të dhëna të tjera personale që vlejnjë për ta identifikuar, si dhe gjeneralitetet e palëve të tjera private;

c) akuzën;

ç) parashtrimin e përmbledhur të rrethanave të faktit dhe provat mbi të cilat bazohet vendimi, si dhe arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta;

d) dispozitivin, duke treguar nenet e zbatuara të ligjit;

dh) datën dhe nënshkrimin anëtarëve të trupit gjykues.

2. Vendimi është i pavlefshëm kur mungon dispozitivi ose nënshkrimi i anëtarëve të trupit gjykues, si dhe kur ka haptazi kontradiktë mes arsyetimit dhe dispozitivit të tij”

shkak të procesit të vetingut¹⁰, por nga ana tjetër vlerësojmë se është detyrë e gjykatës të zbatojë ligjin e garantojë të drejtat e shtetasve dhe për t'ua bërë atyre të drejtën e ankimit të mundur për t'a ushtruar.

Duke parë angazhimin në rritje të institucioneve tona dhe atyre të vendeve të tjera, për të transferuar të dënuarit shqiptarë, pritshmëria është që numri i çështjeve të kësaj natyre të shtohet. Prandaj nisur nga ky rast është e nevojshme që të merren masat e duhura nga të gjithë institucionet e përfshira në procesin e njohjes së vendimit penal të huaj dhe të kryhen të gjitha veprimet për të garantuar në këtë mënyrë respektimin e të drejtave të shtetasve shqiptarë.

Zbatimi i çdo politike penale duhet të ketë në vëmendje dhe qendër zbatimin e të drejtave të njeriut jo vetëm në mënyrë formale, duke i bërë ato të vërteta dhe efektive.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut*" si dhe në mbështetje të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*" i ndryshuar ku përcaktohet se: "*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*".

REKOMANDOJMË:

- Analizimin e këtij rasti dhe marrjen e masave për koordinimin e veprimeve administrative dhe procedurale ndërmjet institucioneve të përfshira në procedurën e njohjes së vendimit të huaj, për të siguruar të drejtën e shtetasit shqiptar që do të transferohet në vendin tonë për të vuajtur pjesën e mbetur të dënimit të dhënë nga një gjykatë huaj, për t'u

¹⁰ Rasti është trajtuar nga gjykata shqiptare para fillimit të reformës në drejtësi.

përfaqësuar në këtë proces në gjykatën shqiptare me një mbrojtës të caktuar prej tij dhe për të ushtruar të drejtën e ankimit.

- Marrjen e masave të nevojshme nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për nxjerrjen e një udhëzimi për të orientuar gjykatat për shënimin në dispozitivin e vendimit penal, të afatit të ankimit, gjykatës ku mund të paraqitet ankimi dhe përlogaritja e afatit, për të garantuar të drejtën e ankimit të palëve në kuadër të procesit të rregullt ligjor.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda Ballanca